



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 18.1.2023

Nr: 15

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**PËRDORIMIN E KODEVE TË SIGURISË PËR PAJISJEN ELEKTRONIKE TË VOTIMIT DHE NUMËRIMIT
ELEKTRONIK TË ZGJEDHËSVE**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, nenit 22, pikat 1, 3 e 5, dhe nenit 99, pika 2, shkronja “dh”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe pikave 10, shkronja “f”, e 12, të vendimit nr. 4, datë 13.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik të zgjedhësve që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

VENDOS:

1. Përdorimin e kodeve të sigurisë për mbylljen e çdo komponenti të brendshëm dhe/ose porte komunikimi fizike të Pajisjeve Elektronike të Votimit dhe Numërimit Elektronik të zgjedhësve (PEVN), si dhe për mbylljen e valixhes për transportimin e PEVN, nga këtu e vijim referuar si Kodet e Sigurisë PEVN.
2. Qëllimi, funksionaliteti dhe karakteristika të përgjithshme të Kodeve të Sigurisë PEVN përshkruhen në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Përcaktimi i sasive të Kodeve të Sigurisë PEVN, si dhe i kriterëve e specifikimeve teknike të tjera veçmas atyre që përmban lidhja nr. 1, bëhet në përputhje me parashikimet e legjislacionit përkatës në fushën e prokurimeve publike.
4. Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Data: 18.1.2023 Nr: 15
Ora: 11:00



“Për përdorimin e kodeve të sigurisë për pajisjen elektronike të votimit dhe numërimit elektronik të zgjedhësve”

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Materiali zgjedhor	Përdorimi	Karakteristika të përgjithshme	Karakteristika të veçanta
Vula me kod sigurie	1. Shërbejnë për vulosjen e të gjitha valixheve të transportit ku mbahet pajisja e votimit elektronik. 2. Gjithashtu këto vula shërbejnë dhe për sigurimin e portës së usb-së, ekranit votimit.	Vulat e sigurisë, kryejnë ruajtjen e kontrolleve të aksesit të sigurisë fizike;	Vulat e sigurisë do kenë një gjatësi të përcaktuar, fleksibël, qendrueshmëri këputjeje për të garantuar paprekshmërinë;
		Vulat e sigurisë, janë të montueshme me një proces të vetëm pa nevojën e mjeteve ndihmëse;	Përbërësit kimikë të vulës, do jenë të tillë që t'i bëjnë ballë kushteve atmosferike, nuk plasariten, nuk deformohen apo nuk ç'ngjyrosen për shkak të ndryshimeve atmosferike;
		Ngjyra e këtyre vulave përcaktohet në varësi të procesit zgjedhor dhe procesit të punës;	Konfigurimi vulës do të jetë i tillë në mënyrë që fshirja ose rishkrimi i numrit të serisë, të lënë gjurmë;
		Vulat e sigurisë janë fleksible, rezistente dhe kanë konfigurim që e bën të pamundur tërheqjen e telit;	Prodhim i vulës do të bëhet me numra serialë të ndryshëm, 6 shifror serial/ laser print/ QR barcode/ "KQZ"- tekst;
		Vulat e sigurisë kanë dizajn, përmbajtje kimike, peshë, diametër, madhësi fizike, ngjyrë, sipas specifikimeve të kërkuara duke ruajtur koston optimale.	Përdorimi i ngjyrave do jetë me kontrast të lartë të bar kodit (e bardhë e verdhë) e ndryshme nga kodet e brendshme (ngjyrë të veçantë për vulat që do të përdoren për mbylljen e kutive dhe ngjyrë të ndryshme për vulat rezervë).